



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1053/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Lego” Sh.p.k, me NUI: 810861113, me seli në Prishtinë, lagjja Veternik p.n, të cilën e përfaqëson Avokat H.Sh. nga Prishtina kundër debitorit “Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Shëndetësisë”, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.70/21 të datës 10.03.2021 të Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 18.08.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Shëndetësisë”, ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.70/21 të datës 10.03.2021 i Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Lego” Sh.p.k, ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.70/21 të datës 10.03.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.2-650-202020 e datës 09.06.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që pas pranimit të këtij urdhri t’i paguajë kreditorit tërësisht borxhin në shumën prej 101,695.00 €, nëse nuk e kryen detyrimin brenda afatit prej 7 ditësh do t’i llogaritet edhe kamatëvonesa në lartësi prej 8 % vjetore nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore. Ndërsa nëse debitorin nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbartuesi privat të zbatoj përmbartimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se kreditori nuk e ka dërguar produktin sipas kërkesës të debitorit prandaj nuk e ka pranuar faturën, ndërsa për produktin i cili është dorëzuar sipas kërkesës është ekzekutuar pagesa. Në vazhdim përmes postës elektronike ka kërkuar nga debitori zëvendësimin e produkteve të cilat nuk janë dorëzuar sipas Autorizim Marketingut MA-00026/11/02/2020 mirëpo pasi që nuk ka reaguar kreditori Ministria e Shëndetësisë (tutje si MSH) ka njoftuar për tërheqjen e mallit nga depoja dhe ka kërkuar faturën e re në përputhje me urdhër blerjen e lëshuar nga MSH. Duke u bazuar në të lartcekurat i propozon Gjykatës ta aprovoj prapësimin si dhe ta shfuqizoj urdhrin përmbartimor ndërsa shpenzimet t'i bartë pala kreditore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim, ka theksuar se pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë, për arsye se gjatë pranimit të mallit nuk ka pasur asnjë ankesë nga debitori ndërsa më vonë përmes postës elektronike i kërkohet të zëvendësohet produkti ushqim parenteral me vëllim 1440ml me të njëjtin produkt por me vëllim prej 2500ml në të kundërt nuk do i kryhej pagesa. Më tej ka shtuar se debitori ka kryer vetëm një pjesë të pagesës ndërsa tjetra ka mbetur si obligim për këtë arsye ka filluar procedura përmbartimore ndërsa për pretendimet e pabaza debitori mund të filloj kontest tjetër në Gjykatën kompetente. Andaj propozon të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor si dhe të obligohet debitori të paguaj shpenzimet e procedurës dhe shpërblimin e përpilimit të përgjigjes në prapësim sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura nr.2-650-202020 e datës 09.06.2020, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se*

në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se Fatura nr.2-650-202020 e datës 09.06.2020 është pranuar pjesërisht nga debitori për sasinë 901 copë ushqim parenteral në vëllim prej 2500 ml sipas Autorizim Marketingut MA-00026/11/02/2020 me vlerë prej 49,555.00 euro e cila pjesë edhe është paguar, ndërsa pjesa tjetër e faturës nuk është pranuar.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, fatura është kundërshtuar pas pranimit të saj, nënkupton se debitori të njëjtën nuk e ka pranuar dhe nuk është pajtuar me përmbajtjen e saj dhe për këtë arsye gjykata vlerëson se faturat e pa nënshkruara dhe të kundërshtuara nga ana e debitorit, paraqesin dokumente të njëanshme dhe si të tilla, nuk janë të përshtatshme për përbarim.

Prandaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përbarim, e mbi bazën e të cilit Përbaruesi Privat ka lejuar përbarimin, nuk ka tipare të përbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e kreditorit lidhur me përmbushjen e kontratës së lidhur mes palëve dhe dorëzimin e produkteve të porositura nga ana e debitorit, erdhi në përfundim se pretendimet e tilla në këtë procedurë janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin e kontratës dhe përmbushjes së saj, sepse i njëjti pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohe vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr.1053/22 datë 18.08.2023

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.